

Programi i Bashkëpunimit

në mes të

**Ministrisë së Punëve të Jashtme
të Republikës së Kosovës**

dhe

**Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane
të Republikës së Kroacisë**

në Fushën e Trajnimit Diplomatik, 2014-2016¹

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane e Republikës së Kroacisë, këtu e tutje referuar si ‘Palët Nënshkruese’,

Duke pasur parasysh mirëkuptimin e ndërsjellë dhe marrëdhëniet efektive bilaterale në mes të dy vendeve, si dhe gatishmërinë për bashkëpunim edhe më të ngushtë në fushën e trajnimit diplomatik, në bazë të Protokollit mbi Bashkëpunim në mes të Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Kroacisë, nënshkruar në Dubrovnik me 26 maj 2012,

Kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi i këtij Programi të Bashkëpunimit është krijimi i një kornize për zbatimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e trajnimit diplomatik për vitin 2014, i cili do të zbatohet dhe zhvillohet në vitin 2015 dhe 2016.

Ky Program i Bashkëpunimit do të përqendrohet në krijimin e një serë aktivitetesh për trajnimin diplomatik themelor për diplomatët dhe shërbyesit tjerë civil të Republikës së Kosovës që merren me marrëdhënie ndërkombëtare, dhe të cilët mund të bëhen më të vet-qëndrueshëm gjatë vitit 2015 dhe 2016, dhe posaçërisht në vitet në vijim.

Palët Nënshkruese do të zbatojnë këtë Program të Bashkëpunimit në kuadër të legjislacionit të tyre kombëtar dhe burimeve që kanë në dispozicion. Palët Nënshkruese do të ofrojnë përkrahje

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

intelektuale, organizative dhe logjistike, ku do të përfshihen edhe aktivitetet e përbashkëta që kanë për qëllim tërheqjen e palëve të tjera të interesuara siç janë organet dhe fondacionet ndërkombëtare.

Neni 2

Palët Nënshkruese do të zbatojnë këtë Program Bashkëpunimi përmes akademive të tyre diplomatike, si dhe nga Qendra e Ekselencës së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Kroacisë.

Projektet e trajnimit diplomatik në kornizën e këtij Programi të Bashkëpunimit do të përgatiten nga ekspertët kroat dhe do të mbështeten përmes strukturave kroate për zhvillim dhe bashkëpunim. Kostoja lokale do të mbulohet nga ana e Kosovës, d.m.th për organizimin dhe logjistikën për projektet që do të realizohen në Prishtinë, shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për trajnerët Kroat dhe trajnerëve të tjerë të angazhuar në Prishtinë, si dhe për të gjithë pjesëmarrësit nga Kosova dhe jashtë saj që marrin pjesë bashkërisht në projekte, nëse është e mundur.

Neni 3

Programi i projekteve të hartuara veçanërisht për trajnime që do të mbahet gjatë vitit 2014 në Prishtinë do të përfshijë si në vijim:

- *‘Përgatitjet për Negociatat me BE-në: Aspektet praktike, ligjore, institucionale dhe funksionale’* – një sërë seminaresh për diplomatët kosovar dhe për shërbyesit tjerë civil që merren me institucionet dhe/ose çështjet e BE-së (datat do të konfirmohen);
- *‘Komunikimi diplomatik: Protokolli, Të shkruarit dhe Planifikimi i Politikave’* – një seri e seminareve, punëtorive dhe prezantimeve për diplomatët e Republikës së Kosovës (datat do të konfirmohen).

Neni 4

Projektet e trajnimit do të mbahen gjatë vitit 2014 në Zagreb dhe/ose diku tjetër në Republikën e Kroacisë për diplomatët e Republikës së Kosovës të cilët do të trajnohen në një mjedis ndërkombëtar së bashku me trajnerët dhe diplomatët nga Republika e Kroacisë por edhe të tjerë nga rajonet më të afërta dhe më gjerë, do të përfshijnë temat në vijim:

- *‘Drejt Integritit në BE-së: Strategjitë e negociimit për vendet candidate’*, seminar diplomatik ndërkombëtar i organizuar nga Qendra e Ekselencës dhe Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Kroacisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Francës, 26-28 shkurt;

- *'Anëtarësimi i Kroacisë në BE: Mësime për Rajonin'* – punëtori ndërkombëtare për diplomatët nga vendet e Ballkanit Perëndimor, mars/prill;
- *Forumi i 17-të Diplomatik në Dubrovnik mbi 'Diplomacinë dhe Trajnimin Diplomatik: Qasje të reja në praktikën diplomatike'* – do të mbahet me 19-21 maj;
- *Seminari i 16-të i përbashkët mbi 'Proceset e Integritimit Evropian' për diplomatët e rinj nga Evropa qendrore, lindore dhe juglindore* – do të mbahet në tetor.

Neni 5

Diplomatët e Republikës së Kosovës janë të ftuar që të marrin pjesë në studimet e reja ndërkombëtare pasuniversitare për 'Diplomaci', që organizohen nga Universiteti i Zagrebit dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane e Republikës së Kroacisë, në Zagreb, në vitin 2014.

Neni 6

Vizitat studimore në Zagreb për stafin e Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe diplomatëve të tjerë të Republikës së Kosovës që janë përgjegjës dhe të angazhuar në trajnimin diplomatik, do të organizohen në vazhdimësi ashtu siç janë pajtuar Palët Nënshkruese, dhe do të përfshijnë:

- *Prezantimi i organizimit dhe aktivitetëve të Drejtorisë për Trajnim Diplomatik, Evropian dhe përgatitje për punë jashtë vendit, përfshirë Akademinë Diplomatike si dhe Qendrën e Ekselencës së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Kroacisë;*
- *Kontribut në kurrikulën e trajnimit të Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, për funksionet diplomatike, konsullore dhe të tjera; të përshtatura për diplomatët e rinj, diplomatët të nivelit të mesëm dhe diplomatët e nivelit të lartë, përfshirë ambasadorët.*

Neni 7

Të gjitha projektet për trajnime diplomatike të përmendura në Nenet 3 deri në 6 do të diskutohen në hollësi dhe do të përgatiten në një formë më të detajuar nga Palët Nënshkruese, në mënyrë që Programi të mund të zbatohet në mënyrë të duhur gjatë vitit 2014.

Projektet për trajnime diplomatike që do të mbahen në vitin 2014, do të paraqesin një bazë për bashkëpunim të mëtejshëm të Palëve Nënshkruese gjatë vitit 2015, përkatësisht vitit 2016.

Palët nënshkruese do të themelojnë një grup të përbashkët punues që të diskutojnë për programin e detajuar të bashkëpunimit për vitet 2015 dhe 2016, respektivisht në janar të vitit 2015 dhe 2016.

Neni 8

Ky Program i Bashkëpunimit do të hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të jetë i zbatueshëm deri me 31 dhjetor të vitit 2016.

Ky Program i Bashkëpunimit mund të ndryshohet me pëlqimin të ndërsjellë me shkrim nga Palët Nënshkruese.

Të gjitha mosmarrëveshjet sa i përket interpretimit ose zbatimit të këtij Programi të Bashkëpunimit do të zgjidhen në mes të palëve nënshkruese përmes konsultimeve.

Nënshkruar në Zagreb, me 21 shkurt 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze.

**Për Ministrinë e Punëve të Jashtme të
Republikës së Kosovës**

**Për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe
Evropiane të Republikës së Kroacisë**